



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 173 Dt. 16.03.2023
PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), si dhe në bazë të Ankesës së KB Trepça të datës 15.03.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 16.03.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Trepça e datës 15.03.2023;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Trepça e datës 15.03.2023 si e pabazuar;

ARSYETIM

Me datë 15.03.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KB Trepça të datës 15.03.2023 (tash e tutje: "Ankesa e KB Trepça"), konform nenit 43 të Propozicioneve të Garave të FBK-së. Ankesa sfidon pikën 2 të Vendimit Nr.16/2023 të Komisionit të Garave të FBK-së të datës 14.03.2023 (tash e tutje: "Vendimi Nr.16/2023").

Në këtë kuadër, dhe brenda afatit përkatës, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 16.03.2023, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Trepça. Në takim kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Elvira Dushku (Sekretare e Përgjithshme e FBK-së) dhe Enea Hajdari (Këshilltare Ligjore për Sport e FBK-së).



Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Trepça sfidon pikën 2 të Vendimit Nr.16/2023 të shkallës së parë, ku Komisioni i Garave refuzon ankesën e KB Trepça pas ndeshjes me KB Sigal Prishtina (xhiro XXV), me arsyetimin se Komisioni Arbitrar (në Vendimin e datës 12.03.2023) ka shfuqizuar vendimin e kontestuar nga KB Trepça (Vendimi Nr.15/2023 i Komisionit të Garave).

Në ankesën drejtuar Komisionit Arbitrar, KB Trepça deklaroi ndër të tjera se në asnjë moment nuk ka pranuar përmes postës elektronike dhe as nuk është informuar se ekziston një vendim i Komisionit Arbitrar i cili e shfuqizon vendimin e Komisionit të Garave Nr.15/2023.

Lidhur me ankesën e KB Trepça, Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Neni 43, alineja 12 e Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023) specifikon se:

“Vendimi i Komisionit Arbitrar i dërgohet klubeve me anë të postës elektronike dhe publikohet në ueb-faqen e FBK-së. Vendimi nënkuptohet i shpallur në momentin kur i është dërguar klubit apo është publikuar në ueb-faqen e FBK-së.”

Fillimisht, duhet theksuar se kuptimi i KB Trepça i Nenit 43, alineja 12 e Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023) se vendimet e Komisionit Arbitrar duhet dërguar të gjitha klubeve nuk qëndron. Kjo, sepse leximi kontekstual i këtij neni na drejton tek përfundimi i arsyeshëm dhe logjik, se Neni 43, alineja 12 i Propozicionit të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023) detyron administratën e FBK-së që vendimet e Komisionit Arbitrar t’ua përcjellë klubeve që janë palë në procedurë e jo të gjitha klubeve. Përderisa, të gjitha klubet e tjera informohen nga plasimi i vendimeve të Komisionit Arbitrar në ueb-faqen e FBK.



Në këtë rast, Vendimi i Komisionit Arbitrar i datës 12.03.2023 i është dërguar klubeve të cilat kanë parashtruar ankesën, pra palëve në procedurë, dhe njëkohësisht është publikuar në ueb-faqen e FBK-së. Sipas nenit të lartpërmendur, vendimi nënkuptohet i shpallur në momentin kur i është dërguar klubit *apo* është publikuar në ueb-faqen e FBK-së. Pra, në të dyja alternativat, vendimi konsiderohet i shpallur, cila do që ka ndodhë, që shihet nga përdorimi i fjalës "apo".

Përkritazi me ankesën e KB Trepça, Komisioni Arbitrar vlerëson se publikimi i Vendimit të Komisionit Arbitrar në vegëzën përkatëse në ueb-faqen e FBK-së nënkupton shpalljen e vendimit në fjalë, dhe për këtë arsye, Komisioni Arbitrar e ka të pamundur të aprovojë ankesën e KB Trepça sepse shpallja në ueb-faqen e FBK nënkupton edhe njoftim publik për të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe KB Trepça, lidhur me vendimin në fjalë.

Përkundër këtij qëndrimi të Komisionit Arbitrar, mirëpo me qëllim të shërbimit sa më të mirë të klubeve të FBK-së (pavarësisht që nuk është detyrim që buron nga Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023)), Komisioni Arbitrar i rekomandon administratës së FBK-së që tash e tutje, nëse ekziston mundësia teknike, të gjitha vendimet e Komisionit Arbitrar t'ua përcjellë të gjitha klubeve edhe përmes postës elektronike, përveç shpalljes në uebfaqe.



Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab R. Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 16 Mars 2023

Vendimi i dërgohet:

- KB Trepça
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



KËSHILLË JURIDIKE:

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.